

GAZETARËT



E DEMOKRACISË

TË SHKRUAJMË PËR DEMOKRACINË

JONI (8), VALZA (8), GOJART (8), LISA (8), GENIT (9), ENES (8), ANDA (8), DRINI (8), ERSISA (8)



Mësoni rreth demokracisë përmes artikullit tonë

Demokracia për herë të parë ka lindur në kryeqytetin e Greqisë, pra në Athinë. Po ashtu, edhe fjala demokraci rrjedh nga gjuha greke „demos“, që do të thotë popull dhe „kratia“ që do të thotë pushtet.

Ne, në demokraci kemi shumë të drejta, për shembull, të drejtën të votojmë, të shprehemi lirshëm, të shkoll-

gjithë jemi të barabartë pa dallim feje, ngjyre ose race. Në demokraci udhëheq populli përmes votës. Demokracia nuk ka qenë në atë kohë siç është sot, për shkak se në votime vetëm burrat e pasur që kanë pasur shumë toka kanë pasur të drejtë të votojnë. Ndërkaq, sot votojnë edhe gratë e jo vetëm burrat e pasur. Ne në demokraci kemi shumë të drejta dhe për këtë arsye na pret një e ardhme e re dhe e ndritur.



lohemi, të luajmë, të zgjedhim profesionin, të ushqehemi etj. Gjithashtu, në demokraci dhuna nuk lejohet, por inkurajohet paqja, dashuria, respekti, mirësjellja, mirëkuptimi, etj. Pra, ne duhet të jemi të respektueshëm, të dëgjueshëm, të mësojmë në shkollë, t'i respektojmë të moshuarit, të mos ofendojmë askënd. Në demokraci, ne të gjithë jemi të barabartë. Për shembull, nëse ne e takojmë një person i cili nuk i takon besimit apo fesë tonë, ne prapë duhet të jemi të respektueshëm ndaj tij. Në sistemin e demokracisë të



Gazetarët e artikullit

NE MUND TË ZGJEDHIM

AID (8), ERONA (8), TOSKA (8), ERDI (8), MEDINA (8), ORGESA (9), ANIK (8), OMAR (8), SHPAT (8)

Ne sot kemi mësuar diçka shumë me vlerë. Ne kemi mësuar për zgjedhjet që mbahen në një shtet demokratik

Sot mësuam për zgjedhjet. Zgjedhjet mund të jenë të ndryshme, si p.sh. kemi zgjedhje lokale dhe zgjedhje qendrore. Me zgjedhje lokale kuptojmë zgjedhjen e kryetarit të komunës dhe asambleistëve, kurse me zgjedhje qendrore ne zgjedhim deputetët.

Por, ne nuk mund të marrim pjesë në një proces zgjedhor deri sa t'i mbushim 18 vjet.

Edhe ne fëmijët mund të zgjedhim, p.sh. ne zgjedhim shokun ose shoqen tonë, zgjedhim kryetarin e klasës, etj. Secili prej nesh sot, kemi shënuar një program, pastaj e kemi lexuar atë dhe në fund e kemi votuar programin më të mirë. Programi më i mirë ka përmbajtur tema si arsimi dhe shëndetësia dhe për këtë arsye ne e votuam.



Gazetarët e Kuvendit të Kosovës




Shpati duke e lexuar programin e tij



Aidi duke votuar



Ilustrimi i Omarit



Zgjedhjet shumëngjyrëshe

PUSHTETI I KOSOVËS DHE NDARJA E TIJ


BLERTA (8), GERTI (8), LEDOR (8), LEDRA (8), BLEART (8), FUAD (8), ORGES (8), AGNESA (8),
ERMIRA (8)

Mënyra e ndarjes së pushtetit dhe funksionet që kryejnë ato institucione


Në familjet tona, punët i ndahen secilit pjesëtar të saj. Edhe Kosova është shtet demokratik, që punët apo pushtetin e saj e ndan në tri pjesë. Ky pushtet iu takon tri institucioneve: Kuvendit, Qeverisë, gjykatave. Kuvendi përbëhet nga 120 deputetë, ku 100 prej tyre janë shqiptarë dhe 20 të tjerë janë të komuniteteve jo shumicë e ato janë: komuniteti serb, turk, boshnjak, romë, egjiptian dhe ashkali. Qeveria i zbaton ligjet që miratohen nga Kuvendi i Republikës së Kosovës. Si dhe pushteti gjyqësor, ka për detyrë t'i mbrojë qytetarët e Republikës së Kosovës, dhe t'i dënojë personat të cilët nuk i respektojnë rregullat dhe e thyejnë ligjin.



Ne, përfaqësuesit e Kuvendit



Pushteti Legjislativ



Pushteti Ekzekutiv




Pushteti Gjyqësor



Ledori e don demokracinë

TË DREJTAT TONA

BLEND (8), BLEND (8), JETA (8), ERINA (9), ERION (8), OMAR (8), REJANA (8), ALTINI (8)



Ne sot mësoam për të drejtat tona, përgjegjësitë dhe rëndësinë tonë në shtëpinë, shkollën, lagjen, shtetin, kontinentin dhe planetin tonë

Sot ne kemi vizatuar, punuar, shkruar, biseduar e gjëra të tjera për qytetarët aktiv dhe të drejtat tona.



Qytetarët e Kosovës janë të gjithë njerëzit, të cilët jetojnë në Kosovë dhe kanë të drejta të barabarta nga shteti. Nuk ka rëndësi ku jetojnë, në fshat apo në qytet. Ne si fëmijë kemi të drejtat dhe përgjegjësitë tona si më poshtë. Në shtëpi, ne kemi të drejtë të pastrojmë, të vishemi, të ushqehemi, të ndihmojmë, etj. Duhet të rregullojmë shtratin, duhet t'i respektojmë rregullat, të respektojmë motrën dhe vëllaun.

Në shkollë, duhet t'i respektojmë rregullat e shkollës,

nuk duhet të vrapojmë, duhet të punojmë detyrat, të mësojmë, ta veshim uniformën dhe të dëgjojmë mësuën.

Në lagjen tonë, kemi nevojë të ujisim lulët, t'i mbledhim mbeturinat, të mbrojmë ambientin dhe t'i ndihmojmë të tjerët.

Për shtetin tonë, duhet të mësojmë, të bëhemi të ditur dhe ta ndihmojmë atë. Gjithashtu, duhet të respektojmë ligjet. Ne duhet të mbrojmë kontinentin tonë, dhe nuk duhet të hedhim mbeturina, sepse shkaktohen sëmundje. Ndërsa në fund, planetin tonë e mbrojmë nëse shkollohemi dhe bëhemi më të ditur.

E tëra kjo mund të arrihet vetëm duke qenë qytetar aktiv dhe duke dhënë më të mirën nga vetja jonë.



Autorët



IMPRESUM



Ky publikim është produkt i punës së pjesëmarrësve të projektit „Demos-ti“ i cili realizohet nga



REPUBLIKA E KOSOVËS / KUVENDI
REPUBLIKA KOSOVA / SKUPŠTINA
REPUBLIC OF KOSOVO / ASSEMBLY

i implementuar nga



Projekti është mundësuar dhe përkrahur nga



ERSTE Stiftung

Redaktohet nga
Kuvendi i Kosovës

Qëllimi i publikimit
Edukimi qytetar nëpërmes metodave edukative joformale

shtypur nga
TOKA

Na kontaktoni për të marrë pjesë:
Tel: +381 38 704 560
E-mail: info@demos-ti.org
Website: www.demos-ti.org

Pjesëmarrësit:
SHFMU „MODEL“
Klasa: III-1
Vendi: Prishtinë